



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 640/6 prot.

Datë 14.04.2025

V E N D I M

Nr. 495/ 2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaïd Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 14.04.2025 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e operatorit ekonomik “REJ” SHPK, në procedurën e prokurimit “E hapur” me nr. REF-25404-10-18-2024 me objekt “Ndërtim Ujësjiellësi Rajonal Trebinjë Burimet e Kozicës, Bashkia Pogradec” me fond limit 451 397 182.5 (katërqind e pesëdhjet e një milion e treqind e nëntëdhjet e shtatë mijë e njëqind e tetëdhjetë e dy pikë pesë) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 03.02.2025 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Pogradec.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me vlerësimin me pikë të propozimeve teknike të paraqitura nga operatori ekonomik “REJ” SHPK

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e operatorit ekonomik “CURRI” SHPK, në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me vlerësimin me pikë të propozimit teknik të paraqitur nga operatori ekonomik “CURRI” SHPK, në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

Ankimues:	Operatori ekonomik “ <i>REJ</i> ” SHPK, me NIPT J93711608Q, me adresa: Sheshi Europa, Pogradec.
Subjekt i interesuar:	Operatori ekonomik “ <i>CURRI</i> ” SHPK, me NIPT J67902718S dhe me adresë Tiranë, Njesia Administrative Nr.10, Rruga Kajo Karafili, Nd.2, H.4, Ap.3, 1001.
Autoriteti Kontraktor:	Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Pogradec Adresa: Rr e Gurasit, Guras, Pogradec.
Baza Ligjore:	Ligji nr. 162/2020 “ <i>Për Prokurimin Publik</i> ”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, “ <i>Për miratimin e rregullave të prokurimit publik</i> ” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “ <i>Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik</i> ”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “ <i>Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19</i> ”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V e r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar.

I.4. Ankimuesi nuk ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 21.10.2024 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “E hapur” me nr. REF-25404-10-18-2024 me objekt “Ndërtim Ujësjiellësi Rajonal Trebinjë Burimet e Kozicës, Bashkia Pogradec” me fond limit 451 397 182.5 (katërqind e pesëdhjet e një milion e treqind e nëntëdhjet e shtatë mijë e njëqind e tetëdhjetë e dy pikë pesë) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 03.02.2025 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Pogradec.

II.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimit elektronik rezulton, se me datë 03.02.2025 është zhvilluar procedura e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe informacionit të operatorit ekonomik ankimues rezulton, se në datën 25.02.2025, është bërë klasifikimi i operatorëve ekonomikë pjesëmarrës, duke i njoftuar me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të ofertave ekonomike për vlerat (pa TVSH) si më poshtë:

- | | | |
|----------------------|-----------------------------|-------------|
| 1. OE “CURRI” Sh.p.k | 414,733,506.03 lekë pa tvsh | Kualifikuar |
| 2. OE “REJ” Sh.p.k | 374,445,351.75 lekë pa tvsh | Kualifikuar |

II.4. Nga verifikimet në sistemin e prokurimit elektronik rezulton, se me datë 26.02.2025 është publikuar “Njoftimi i fituesit paraprak” në SPE dhe publikuar në Buletinin e Njftimeve Publike nr. 11 datë 03.03.2025, ku është shpallur fitues OE “CURRI” SHPK.

II.5. Në datën 05.03.2025 nëpërmjetë sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. Elektronik A/2025/5111 dhe me nr. 640/2025 prot, datë 05.03.2025 e operatorit ekonomik “REJ” SHPK, duke kundërshtuar vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin dhe vlerësimin me 0 pikë të propozimit teknik të paraqitur nga operatori ekonomik “REJ” SHPK. Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik publikoi pretendimet e operatorit ekonomik “REJ” SHPK që të skualifikohet operatori ekonomik “CURRI” SHPK, për mospërbushjen e kriterëve nga ky i fundit, nga procedura e prokurimit të sipërcituar.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 640/1 Prot., datë 06.03.2025, lidhur me pretendimet për skualifikimin dhe vlerësimin me 0 pikë të propozimit teknik të paraqitur nga operatori ekonomik “REJ” SHPK. Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik publikoi pretendimet e operatorit ekonomik “REJ” SHPK që të skualifikohet operatori ekonomik “CURRI” SHPK, për mospërbushjen e kriterëve nga ky i fundit, nga procedura e prokurimit të sipërcituar.

II.7. Me shkresën nr. 23/28 prot, datë 06.03.2025 me objekt: “Vendim për shqyrtim ankesë” protokolluar me tonën me nr. 640/2 prot., datë 06.03.2025, është dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimes “REJ” SHPK. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor, ky i fundit ka argumentuar se:

Referuar bazës ligjore të sipërcituar, Komisioni për shqyrtimin e ankesës gjykon, se afati për dorëzimin e ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për kundërshtimin e vendimit të KVO-së lidhur me vlerësimin/klasifikimin përfundimtar, është 7 ditë (24 orë) nga publikimi i njoftimit të fituesit ose i njoftimit të anulimit.

Në rastin konkret në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) afati për paraqitjen e ankesës (publikimi në sistem i njoftimit paraprak të fituesit) ka filluar në datë 26.02.2025 ora 09:53 dhe ka përfunduar në datë 05.03.2025 ora 09:53. Pra në sistemin e prokurimit elektronik është shfaqur mbishkrimi “Afati i ankimit ka përfunduar”, duke lejuar autoritetin kontraktor për të vazhduar me hapat e mëtejshëm të procedurës.

Autoriteti Kontraktor mbas kontrollit here pas here të sistemit të ankesave, pasi ka konstatuar se në sistem nuk ka pasur asnjë ankesë ka vijuar me dërgimin për publikim në SPE të njoftimit përfundimtar të fituesit.

Rreth orës 14:30 është shfaqur në sistemin e ankesave, ankesa e operatorit ekonomik Rej shpk e cila është aplikuar online në datë 05.03.2025 ora 12:54:45 dhe mban nënshkrimin elektronik datë 05.03.2025 ora 01:43:23

Për sa më sipër kemi marrë masa për të njoftuar app-me email për mospublikimin e njoftimit përfundimtar të fituesit deri me marrjen e një vendimi përfundimtar nga Komisioni I Prokurimit Publik.

Komisioni I shqyrtimit të ankesës gjykon se ankesa është dorëzuar pasi ka përfunduar afati ligjor për dorëzimin e ankesave dhe e konsideron atë të pa paraqitur.

Në keto kushte nuk është përmbushur detyrimi për ndjekjen e afateve ligjore të ankimit dhe komisioni i ankesës në përputhje me nenin 102 pika vkm nr 285/2021 pika b vendosi

Mospranimin e ankesës .

II.8. Me shkresën e datës 21.03.2025, protokolluar me tonën me nr. 640/3 prot., datë 25.03.2025, operatori ekonomik ankimes ka paraqitur kundërshtimin e tij ndaj vendimit për shqyrtimin e ankesës nga autoriteti kontraktor.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Në datën 21.10.2024 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “E hapur” me nr. REF-25404-10-18-2024 me objekt “Ndërtim Ujësjellësi Rajonal Trebinjë Burimet e Kozicës, Bashkia Pogradec” me fond limit 451 397 182.5 (katërqind e pesëdhjet e një milion e treqind e nëntëdhjet e shtatë mijë e njëqind e tetëdhjetë e dy pikë pesë) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 03.02.2025 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Pogradec.

III.1.1. Nga verifikimet në sistemin e prokurimit elektronik rezulton, se me datë 03.02.2025 është zhvilluar procedura e prokurimit objekt-ankimi.

III.1.2. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe informacionit të operatorit ekonomik ankimues rezulton, se në datën 25.02.2025, është bërë klasifikimi i operatorëve ekonomikë pjesëmarrës, duke i njoftuar me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të ofertave ekonomike për vlerat (pa TVSH) si më poshtë:

- | | | |
|----------------------|-----------------------------|-------------|
| 1. OE “CURRI” Sh.p.k | 414,733,506.03 lekë pa tvsh | Kualifikuar |
| 2. OE “REJ” Sh.p.k | 374,445,351.75 lekë pa tvsh | Kualifikuar |

III.1.3. Nga verifikimet në sistemin e prokurimit elektronik rezulton, se me datë 26.02.2025 është publikuar “Njoftimi i fituesit paraprak” në SPE dhe publikuar në Buletinin e Njftimeve Publike nr. 11 datë 03.03.2025, ku është shpallur fitues OE “CURRI” SHPK.

III.1.4. Në datën 05.03.2025 nëpërmjetë sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. Elektronik A/2025/5111 dhe me nr. 640/2025 prot, datë 05.03.2025 e operatorit ekonomik “REJ” SHPK, duke kundërshtuar vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin dhe vlerësimin me 0 pikë të propozimit teknik të paraqitur nga operatori ekonomik “REJ” SHPK. Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik publikoi pretendimet e operatorit ekonomik “REJ” SHPK që të skualifikohet operatori ekonomik “CURRI” SHPK, për mospërbushjen e kriterëve nga ky i fundit, nga procedura e prokurimit të sipërcituar.

III.1.5. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 640/1 Prot., datë 06.03.2025, lidhur me pretendimet për skualifikimin dhe vlerësimin me 0 pikë të propozimit teknik të paraqitur nga operatori ekonomik “REJ” SHPK. Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik publikoi pretendimet e operatorit ekonomik “REJ” SHPK që të skualifikohet operatori ekonomik “CURRI” SHPK, për mospërbushjen e kriterëve nga ky i fundit, nga procedura e prokurimit të sipërcituar.

III.1.6. Me shkresën nr. 23/28 prot, datë 06.03.2025 me objekt: “Vendim për shqyrtim ankese” protokolluar me tonën me nr. 640/2 prot., datë 06.03.2025, është dërguar pranë Komisionit të

Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimes “REJ” SHPK. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor, ky i fundit ka argumentuar se:

Referuar bazës ligjore të sipërcituar, Komisioni për shqyrtimin e ankesës gjykon, se afati për dorëzimin e ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për kundërshtimin e vendimit të KVO-së lidhur me vlerësimin/klasifikimin përfundimtar, është 7 ditë (24 orë) nga publikimi i njoftimit të fituesit ose i njoftimit të anulimit.

Në rastin konkret në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) afati për paraqitjen e ankesës (publikimi në sistem i njoftimit paraprak të fituesit) ka filluar në datë 26.02.2025 ora 09:53 dhe ka përfunduar në datë 05.03.2025 ora 09:53. Pra në sistemin e prokurimit elektronik është shfaqur mbishkrimi “Afati i ankimit ka përfunduar”, duke lejuar autoritetin kontraktor për të vazhduar me hapat e mëtejshëm të procedurës.

Autoriteti Kontraktor mbas kontrollit herë pas herë të sistemit të ankesave, pasi ka konstatuar se në sistem nuk ka pasur asnjë ankesë ka vijuar me dërgimin për publikim në SPE të njoftimit përfundimtar të fituesit.

Rreth orës 14:30 është shfaqur në sistemin e ankesave, ankesa e operatorit ekonomik Rej shpk e cila është aplikuar online në datë 05.03.2025 ora 12:54:45 dhe mban nënshkrimin elektronik datë 05.03.2025 ora 01:43:23

Për sa më sipër kemi marrë masa për të njoftuar app-me email për mospublikimin e njoftimit përfundimtar të fituesit deri me marrjen e një vendimi përfundimtar nga Komisioni I Prokurimit Publik.

Komisioni I shqyrtimit të ankesës gjykon se ankesa është dorëzuar pasi ka përfunduar afati ligjor për dorëzimin e ankesave dhe e konsideron atë të pa paraqitur.

Në këto kushte nuk është përmbushur detyrimi për ndjekjen e afateve ligjore të ankimit dhe komisioni i ankesës në përputhje me nenin 102 pika vkm nr 285/2021 pika b vendosi

Mospranimin e ankesës .

III.1.7. Me shkresën e datës 21.03.2025, protokolluar me tonën me nr. 640/3 prot., datë 25.03.2025, operatori ekonomik ankimes ka paraqitur kundërshtimin e tij ndaj vendimit për shqyrtimin e ankesës nga autoriteti kontraktor.

III.1.8. Neni 24, pika 1, “Komisioni i prokurimit Publik” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, ndryshuar, parashikon se:

“Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit dhe kryen çdo detyrë tjetër që i ngarkohet me këtë ligj dhe akte të tjera ligjore brenda fushës së kompetencave të tij.

Komisioni i Prokurimit Publik administron të dhënat e Sistemit të Ankesave Elektronike.”

III.1.9. Neni 30, pika 1, “Veprimtaria e Komisionit të Prokurimit Publik” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikon se:

“Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera. Shqyrtimi i ankesave për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar do të bëhet nga 3 anëtarë të Komisionit të Prokurimit Publik”.

III.1.10. Në nenin 110, pikat 2, 7 dhe 8 “Afatet për ankimim” të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: “2. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen **brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimi të anulimit.**

Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.

7. Në rast se operatori ekonomik nuk paraqet ankesën brenda afateve të parashikuara në këtë nen, atëherë nuk ka mundësi të ushtrojë më të drejtën e ankimit pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

8. Të shtunat, të dielat dhe ditët e festave zyrtare nuk pengojnë fillimin dhe kohëzgjatjen e afateve. Kur dita e fundit e një afati bie e shtunë, e diel ose një ditë feste zyrtare, afati mbaron në ditën e punës që vjen pas saj. Ankesa quhet e pranuar në ditën e depozitimit të saj pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.”.

III.1.11. Në nenin 111, pika 1, të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “1. Operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik. Rregulla të posaçme për mënyrën e paraqitjes së ankesës përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.”.

III.1.12. Neni 112, pikat 1 dhe 2 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikon shprehimisht se: “1. Me regjistrimin e ankesës në Sistemin e Ankesave Elektronike dhe publikimin e saj nga Komisioni i Prokurimit Publik, Sistemi i Prokurimit Elektronik në ndërveprim me Sistemin e Ankesave Elektronike pezullon në mënyrë automatike vazhdimin e procedurës së prokurimit deri në shqyrtimin plotësisht të ankesës, përfshirë edhe nxjerrjen e një vendimi nga Komisioni i Prokurimit Publik me nënshkrim dhe vulë elektronike. Sistemi duhet të zhvillohet duke përdorur teknologji të avancuara të inteligjencës artificiale dhe procese të robotizuara për të kryer pezullimin dhe nxjerrjen nga pezullimi automatik i procedurave të prokurimit.

2. Komisioni i Prokurimit Publik, me marrjen e ankesës në përputhje me këtë ligj, publikon në bazën e të dhënave përmes ndërveprimit me sisteme të treta, të dhënat e mëposhtme:

a) për ankimuesin, adresën dhe NUIS-in;

b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës).”

III.1.13. Në nenin 114, pikat 1 dhe 4, “Trajtimi i ankesës nga autoriteti ose enti kontraktor” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “1. Në rastet e ankesave për procesin e vlerësimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet për ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga përfundimi i afatit kohor në dispozicion të operatorëve ekonomikë të interesuar, sipas parashikimeve në nenin 113 të këtij ligji, për paraqitjen e argumenteve të tyre.

“4. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor vë në dijeni për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin, operatorët ekonomikë të interesuar brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.

5. Kundër vendimit të autoritetit ose entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik brenda 7 ditëve nga marrja e njoftimit nga autoriteti ose enti kontraktor për procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar dhe brenda 10 ditëve për procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, sipas pikës 4 të këtij neni.

6. Nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur ankesë sipas pikës 5 të këtij neni, ata nuk do të kenë të drejtë të paraqesin më pas një ankesë për veprimet e autoritetit ose entit kontraktor, të kryera në zbatim të vendimit të dhënë nga Komisioni i Prokurimit Publik”.

III.1.14. Në nenin 115 pika 1, “Trajtimi i ankesës nga Komisioni i Prokurimit Publik” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: “1. Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.”

III.1.15. Në nenin 118, pika 2, gërma “a” të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar parashikohet se: “Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë: “a) të refuzojë ankesën për shkak të mosplotësimit të elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e saj dhe mosrespektimit të afateve të ankimit, sipas parashikimeve të neneve 110 dhe 111 të këtij ligji;”

III.1.16. Referuar bazës ligjore të sipërcituar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se afati për dorëzimin e ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për procesin e vlerësimit të ofertave, është 7 ditë nga publikimi i njoftimit të fituesit ose i njoftimit të anulimit. Në rastin konkret, afati i fundit për paraqitjen e ankesës në autoritetin ose entin kontraktor, si dhe njëkohësisht në Komisionin e Prokurimit Publik, referuar datës së publikimit të njoftimit të fituesit paraprak është publikuar më datë 26.02.2025, ka qenë data 04.03.2025. KPP vëren, se operatori ekonomik ankimues “REJ” SHPK, me datë 05.03.2025, ka paraqitur ankesë nëpërmjetë sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, ku kundërshton skualifikimin dhe vlerësimin me 0 pikë të propozimit teknik të paraqitur nga operatori ekonomik “REJ” SHPK, pra jashtë afateve të ankimit, kur ndërkohë duhet të ishte dorëzuar në sistemin e ankesave elektronike jo më vonë se në datën 04.03.2025, si pranë autoritetit kontraktor, ashtu edhe Komisionit të Prokurimit Publik duke mos u legjitimuar racione temporis.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se ligji stricto sensu ka parashikuar, se ankesa dorëzohet njëherazi, si pranë autoritetit ose entit kontraktor ashtu edhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe është përgjegjësi e operatorit ekonomik ankimues, që të dorëzojë këtë të fundit njëherazi në të dyja institucionet përmes sistemit të ankesave elektronike, brenda afatit të parashikuar në ligj.

Në nenin 118, pika 2, gërma “a” të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar parashikohet se: *“Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë: a) të refuzojë ankesën për shkak të mosplotësimit të elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e saj dhe mosrespektimit të afateve të ankimit, sipas parashikimeve të neneve 110 dhe 111 të këtij ligji;”*

Sa më sipër arsyetuar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se ankesa e dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues në sistemin e ankesave elektronike, nuk ka përmbushur detyrimin për ndjekjen e afateve ligjore të ankimit në autoritet kontraktor dhe në Komisionin e Prokurimit Publik, ndaj përbën shkak për mospranimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik.

KPP, me këtë rast, gjen me vend të theksojë se, ndërsa çdo subjekt i LPP ka të drejtë të interpretojë dispozitat e këtij legjislacioni, po ashtu, këto subjekte kanë edhe detyrimin ta interpretojnë atë në përputhje e harmoni të brendshme dhe të jashtme me legjislacionin tjetër në fuqi në Republikën e Shqipërisë por edhe me Kushtetutën si ligji më i lartë në vend referuar parashikimeve të nenit 4/2 të saj. Kushtetuta vetë parashikon hierarkinë, statusin dhe efektin e normave ligjore. Kuadri kushtetues ka parashikuar hierarkine e normave ligjore në nenin 116 të Kushtetutës në të cilin parashikohet se: *“1. Aktet normative që kanë fuqi në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë janë:*

a) Kushtetuta;

b) marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara;

c) ligjet;

ç) aktet normative të Këshillit të Ministrave.

2. Aktet që nxirren nga organet e pushtetit vendor kanë fuqi vetëm brenda juridiksionit territorial që ushtrojnë këto organe.

3. *Aktet normative të ministrave dhe të organeve drejtuese të institucioneve të tjera qendrore kanë fuqi në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë brenda sferës së juridiksionit të tyre.*” Në këtë kuadër Kushtetuta vetë, duke folur për hierarkinë e akteve normative në nenin 116 të saj, parashikon akte normative që janë “nën” ligjet sic është në rastin konkret VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Në këtë mënyrë, duke qenë se ligjet kanë epërsi mbi aktet normative të Këshillit të Minsitrave, KPP në vendimarrjen e tij i qëndron strikt këtij rregullimi si organi më i lartë në fushën e prokurimit publik, i cili ka të drejtën dhe përgjegjësinë të bëjë interpretimin përfundimtar të legjislacionit të fushës përkatëse duke llogaritur afatet e ankimit të operatorëve ekonomikë sipas parashikimeve të nenit 110 pika 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar.

III.1.17. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se referuar nenit 111, pika 1 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik. Në rastin konkret referuar dokumentacionit të administruar rezulton, se operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik jashtë afatit të parashikuar nga neni 110, pika 2 e Ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, i cili parashikon se “2. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të **ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimi të anulimit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.**”

Referuar parashikimeve të sipërcituara, në rastin konkret, llogaritja e afatit për ankim pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, nis ditën e publikimit të njoftimit të fituesit më datë 26.02.2025 dhe përfundon në ditën e 7-të. Në rastin konkret, afati i fundit për paraqitjen e ankesës në autoritetin ose entin kontraktor, si dhe njëkohësisht në Komisionin e Prokurimit Publik, referuar datës së publikimit të njoftimit të fituesit paraprak, ka qenë data 04.03.2025. Ndërkohë ankesa e depozituar nëpërmjetë sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor me datë 05.03.2025 konsiderohet e paraqitur jashtë afateve ligjore të ankimit, duke mos u legjitimuar *ratione temporis*. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se ligji *stricto sensu* ka parashikuar, se ankesa dorëzohet njëherazi si pranë autoritetit ose entit kontraktor ashtu edhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe është përgjegjësi e operatorit ekonomik ankimues, që ta dorëzojë këtë të fundit njëherazi në të dyja institucionet, brenda afatit të parashikuar në ligj.

Në nenin 118, pika 2, gërma “a” të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “ *Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë: të refuzojë ankesën, për shkak të mosplotësimit të elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e saj, sipas parashikimeve të nenit 111 të këtij ligji*”.

Sa më sipër arsyetuar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se ankesa e dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues, nuk ka përmbushur detyrimin për ndjekjen e afateve ligjore të ankimit, ndaj përbën shkak për mospranimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik. Komisioni i Prokurimit Publik rithekson bindjen e tij, se për shkak të specifikës së prokurimeve publike, respektimi i afateve është i një rëndësie thelbësore, e me ndikim të

drejtpërdrejtë në efikasitetin e procedurës, ndaj edhe i qëndron strikt rregullit të parashikuar nga ligji i prokurimit publik si *lex specialis* mbi lëndën.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik ankimues “REJ” SHPK, në procedurën e prokurimit “E hapur” me nr. REF-25404-10-18-2024 me objekt “Ndërtim Ujësjellësi Rajonal Trebinjë Burimet e Kozicës, Bashkia Pogradec” me fond limit 451 397 182.5 (katërqind e pesëdhjet e një milion e treqind e nëntëdhjet e shtatë mijë e njëqind e tetëdhjetë e dy pikë pesë) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 03.02.2025 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Pogradec.
 2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
 3. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “REJ” SHPK
 4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar	Anëtar	Anëtar	Anëtar
Fiorent Zguro	Kreshnik Ternova	Anila Malaj	Gjergj Mersini

Kryetar

Jonaid Myzyri

